



PRILL
2023



Advocacy Center
for **Democratic Culture**

BULETINI



Programi i praktikës

INë prill, OJQ ACDC nënshkroi kontrata me juristët e rinj të përzgjedhur, duke u dhënë atyre mundësinë për të zgjeruar njohuritë dhe përvojën e tyre gjatë 3 muajve të ardhshëm.

Një nga aktivitetet më të rëndësishme në kuadër të këtij programi është simulimi i seancës gjyqësore që praktikantët do ta përgatisin dhe do ta paraqesin në fund të programit për të promovuar rëndësinë e përfshirjes së juristëve të rinj nga veriu në praktikën juridike në Kosovë.

Programi i praktikës është pjesë e projektit “Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe në Kosovë”, financuar nga INL Kosova.



Advocacy Center
for Democratic Culture

Social networks



+381 (0) 64 11 77 871
+383 (0) 44 53 98 52
office@acdc-kosovo.org

Kampanja në rrjete sociale

Ne kemi filluar kampanjën e re në rrjetet sociale #njohtëdrejtattuaja për të siguruar që gratë shtatzëna dhe nënat e reja të jenë të vetëdijshme për të drejtat e tyre në vendin e punës. Kampanja do të sigurojë informata bazë për të mbrojtur të drejtat tuaja gjatë pushimit të lehonisë dhe prindërimit.

Shikoni pjesën parën në serinë e publikimeve të koordinuara në rrjetet sociale në kuadër të kampanjës sonë për promovimin e të drejtave të amësisë në Kosovë.



Hulumtimi mbi të drejtat e punës së nënave të reja

Kjo fushatë u publikua pas hulumtimit mbi të drejtat e punës së grave shtatzëna dhe nënave të reja, që theksoi rëndësinë e mosdiskriminimit në ligjin e punës dhe hodhi dritë mbi perceptimet e grave në lidhje me të drejtat dhe detyrat e punonjësve.

Publikimi është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të projektit "Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të punës të grupeve të cenueshme në tregun e punës", i zbatuar nga Qendra për Trajnime dhe Burime për Avokim - ATRC në partneritet me BIRN Kosovë.

Analiza është e disponueshme në faqen tonë të internetit në anglisht, serbisht dhe shqip.



OJQ ACDC ka marrë përkrahje nga Smart Balkans për projekt të ri, "Promovimi i të Drejtave dhe Rolit të Qytetarëve përmes Reduktimit të Rrezikut të Fatkeqësive Natyrore". Ky projekt synon të rrisë ndërgjegjësimin për rreziqet e fatkeqësive dhe ndryshimeve klimatike, duke promovuar gjithashtu kohezionin social ndërmjet anëtarëve të komunitetit për të arritur rezultate afatgjata dhe për të përmirësuar ndikimin e proceseve vendimmarrëse në këtë fushë.

Ne ishim të nderuar të merrnim pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes së grantit me ekipin e Smart Balkan më 28 Mars.





Shihni se çfarë kanë thënë për mediat drejtori ynë ekzekutiv, Dushan Radaković dhe drejtori i programit, Aleksandar Rapajiq në lidhje me zgjedhjet në veri të Kosovës.

Dushan Radaković për RTS për zgjedhjet në veri të Kosovës



Dushan Radaković për Kosovo Online për zgjedhjet në veri të Kosovës



Dushan Radaković në emisionin "Razgovor" në RTK2



Aleksandar Rapajiq për Tanjug për zgjedhjet në veri të Kosovës



Aleksandar Rapajiq për Al Jazeera për liberalizimin e vizave për Kosovën



OJQ ACDC, si anëtare e koalicionit Demokracia në Veprim, ishte përfshirë në mënyrë aktive në monitorimin e zgjedhjeve të mbajtura në veri të Kosovës në muajin prill.



Së bashku me Demokracinë në Veprim, ne nënshkruam një deklaratë të përbashkët për medie, ku thuhej se; derisa zgjedhjet plotësojnë kriteret minimale ligjore, ato nuk garantojnë legjitimitetin politik dhe përfaqësimin e institucioneve që rezultojnë nga zgjedhjet.

[SRB](#)

[ALB](#)

[ENG](#)

Deklaratat në ditët ndërkombëtare



Ne besojmë se është e rëndësishme të njohim dhe kremtojmë diversitetin e komunitetit tonë global

Më 8 Prill, ne shënuam Ditën e Romëve, një ditë për të nderuar dhe kremtuar kulturën rome.



Në njohje të rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit, ne shënuam Ditën e Tokës më 21 Prill.



Më 28 Prill, ne shënuam Ditën Botërore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë për të promovuar dhe rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e parandalimit të lëndimeve, aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës.

N j o f t i m e



Përveç iniciativave tona të vazhdueshme, aktualisht jemi duke realizuar hulumtime për diskriminimin në Mitrovicën e Veriut, të cilat do të publikohen muajin e ardhshëm.

Gjithashtu, ne po zhvillojmë një platformë të personalizuar online për Zyrën për Çështje të Komuniteteve për të ofruar mbështetje për përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë, e cila do të prezantohet në muajt e ardhshëm.



Për më tepër, ACDC mbetet e përkushtuar në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas për ata që përballen me sfida në ushtrimin e të drejtave të tyre në Kosovë.

ACDC ka publikuar së fundmi një thirrje për aplikime për pozitën e koordinatorit të projektit. Kandidati/ja i suksesshëm do të shpallet në maj.

Për të mësuar më shumë rreth punës sonë, vizitoni faqen tonë të internetit ose faqet e rrjeteve sociale.



**Advocacy Center
for Democratic Culture**



www.acdc-kosovo.org